

UDHËZIM

Nr.7, datë 10.11.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.6, DATË 21.10.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.10 289, DATË 17.6.2010 “PËR MËNYRËN E TRAJTIMIT EKONOMIK E FINANCIAR DHE PËR DHËNIE NDIHME TË MENJËHERSHME FAMILJEVE TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË GARDËS SË REPUBLIKËS, TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM, TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE TË SHPËTIMIT, TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT DHE TË POLICISË SË BURGJEVE, QË HUMBIN JETËN NË KRYE APO PËR SHKAK TË DETYRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme

familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës të Shërbimit të Kontrollit të

Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të

detyrës” dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e

Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.6, datë 21.10.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Në zbatim të nenit 6 të ligjit, trajtimi me strehim i familjeve të punonjësve, që kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës, bëhet sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin

nr.6257, datë 2.9.2008 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe të Ministrit të Financave

“Për përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, të

ndryshuar, duke përfituar subvencionim të plotë të interesit të kredisë (kredi me interes 0%) sipas

pikave 7 e vijuese të udhëzimit.

Lista e miratuar nga Ministria e Brendshme i përcillet Entit Kombëtar të Banesave, i cili e trajton me përparësi duke e dërguar në bankën e përzgjedhur nga Ministria e Financave për zbatimin

e programit të subvencionit për familjet, që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti. Lista e miratuar

nga Ministria e Brendshme duhet të shoqërohet me:

- Certifikatë të gjendjes familjare aktuale.

- Vërtetim negativ nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e vendit ku banojnë, që, në emër të kryefamiljarit dhe të anëtarëve të tjerë të familjes, nuk figuron pronë e regjistruar apo

në proces regjistrimi.”.

2. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe

Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij udhëzimi.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha